



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-028
Prishtinë, më 16 korrik 2008, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 16 KORRIK 2008**

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Nexhat Daci, Naim Maloku, Ibrahim Gashi, dhe Sllobodan Petroviq, ndërsa munguan Eqrem Kryeziu dhe Xhezair Murati;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Lulzim Zeneli, Ardian Gjini dhe Zylfi Merxha, ndërsa munguan Ibrahim Makolli dhe Bojan Stojanovq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Skënder Reçica dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi dhe Eshref Vishi;

Nga NDI: Petrit Hysaj; dhe

Nga OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.
Ai i propozoi edhe tri pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 2 korrik 2008,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave, dhe
4. Të ndryshme.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 8 korrik 2008

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 8 korrik 2008, u miratuan pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare

Kryetari i informoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me materialet e përgatitura për seancën e radhës. Ai kërkoi pëlqimin e tyre për secilën pikë të propozuar, veç e veç.

Lulzim Zeneli kërkoi që rekomandimet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me gjendjen në parkun nacional “Malet e Sharrit” dhe në fshatin turistik Prevallë të radhiten për seancën e radhës.

Pas debatit që u zhvillua lidhur me këtë propozim, u vendos që Komisioni t’ia paraqesë Kryesisë të gjitha të dhënat që i ka mbledhur nga terreni dhe nga komuna e Prizrenit lidhur me temën e ngritur.

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca e radhës të mbahet më **29 korrik 2008**, në orën 10:00, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 15 korrik 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi parë i Projektligjit për partneritetet publiko-privat dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës së shërbimeve publike dhe procedurat për dhënien e tyre,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vula në institucionet e Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2007,
6. Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për tërheqjen e ligjeve nga procedura e shpalljes.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të AKR-së për ta ftuar në Interpelancë ministrin e Punëve të Jashtme, Skënder Hyseni.

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Grupit Parlamentar të AKR-së, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkesa e Grupit Parlamentar të AKR-së për ta ftuar në interpelancë ministrin e Punëve të Jashtme, Skënder Hyseni, i dërgohet Qeverisë për ta shqyrtuar në përputhje me nenin 65.9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me Rregullën 25 të Rregullores së Kuvendit.

3.2 Shqyrtimi i kërkesës së Qeverisë së Kosovës për tërheqjen nga procedura e shpalljes së ligjeve

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Qeverisë së Kosovës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Mbështet kërkesa e Qeverisë së Kosovës për tërheqjen nga procedura e shpalljes së dhjetë (10) ligjeve.
2. Kërkesa e Qeverisë për tërheqjen nga procedura e shpalljes së dhjetë (10) ligjeve i procedohet seancës plenare për vendosje.

3.3 Shqyrtimi i Informatës për QAP në Gërmi

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me çështjen e Qendrës Administrative Protokollare në Gërmi, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet sekretari i Kuvendit që ta përgatisë dhe t'ia paraqesë Kryesisë së Kuvendit për mbledhjen e ardhshme një Raport me rekomandime për veprimet e mëtejme që duhet t'i marrë Kuvendi lidhur me Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi

Kryesuesi e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 11:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

E hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale